

Rome, 24 August 2026

**EXTRACT OF THE RESOLUTION OF THE BOARD OF DIRECTORS OF FINCANTIERI S.p.A.
DATED 20 APRIL 2026**

At the meeting of the Board of Directors of FINCANTIERI S.p.A. ("Fincantieri"), held on 20 April 2026, the approval of the transaction aimed at establishing a "Joint Venture" in Albania with KAYO SH.A. (the "Transaction") was resolved.

Within the framework of such resolution, the Board of Directors granted to the Chairman of the Board of Directors of Fincantieri, Dr. Biagio Mazzotta, born in Rome on 7 April 1962, and to the Chief Executive Officer of Fincantieri, Dr. Pierroberto Folgiero, born in Rome on 9 June 1972, each acting separately and with the power to sub-delegate, the broadest powers to define, conclude and execute the Transaction.

In particular, the Chief Executive Officer of Fincantieri, Dr. Pierroberto Folgiero, was authorised, also acting separately from the Chairman of the Board of Directors, to negotiate, define, sign, enter into, execute and, where necessary, amend all deeds, preliminary and final agreements, as well as to carry out all formalities necessary, useful and/or appropriate for the implementation and completion of the Transaction.

The powers granted also include the authority to participate in meetings of the corporate bodies in the capacity of shareholder, to appoint the members of the corporate bodies, to determine the content, subject matter, terms, clauses and conditions of the deeds and agreements relating to the Transaction, including those of an economic and financial nature, as well as to fulfil any tax obligation and to carry out any further act necessary, appropriate and/or useful for the full and final implementation of the Transaction.

Such powers shall be exercised on the condition that the final terms of the Transaction do not deviate in materially less favourable terms from those presented to the Board of Directors.

Alessandra Battaglia
Secretary of the Board of Directors
of FINCANTIERI S.p.A.

**FINCANTIERI S.p.A.**



Romë, 24 gusht 2026

**EKSTRAKT I VENDIMIT TË KËSHILLIT TË ADMINISTRIMIT TË FINCANTIERI S.p.A.
DATË 20 PRILL 2026**

Në mbledhjen e Këshillit të Administrimit të FINCANTIERI S.p.A. ("Fincantieri"), të mbajtur më datë 20 prill 2026, u miratua operacioni që synon krijimin e një "Joint Venture" në Shqipëri me KAYO SH.A. ("Transaksioni").

Në kuadër të këtij vendimi, Këshilli i Administrimit i dha Kryetarit të Këshillit të Administrimit të Fincantieri-t, Dr. Biagio Mazzotta, lindur në Romë më 7 prill 1962, dhe Administratorit (CEO) të Fincantieri-t, Dr. Pierroberto Folgiero, lindur në Romë më 9 qershor 1972, secilit me të drejtë për të vepruar veçmas dhe me të drejtë nëndelegimi, kompetencat më të gjera për të përcaktuar, përfunduar dhe zbatuar Transaksionin.

Në veçanti, Administratori (CEO) i Fincantieri-t, Dr. Pierroberto Folgiero, u autorizua, gjithashtu duke vepruar veçmas nga Kryetari i Këshillit të Administrimit, të negociojë, përcaktojë, nënshkruajë, lidhë dhe zbatojë, si dhe, kur është e nevojshme, të ndryshojë të gjitha aktet, marrëveshjet paraprake dhe përfundimtare, si dhe të kryejë të gjitha formalitetet e nevojshme, të dobishme dhe/ose të përshtatshme për zbatimin dhe përfundimin e Transaksionit.

Kompetencat e dhëna përfshijnë gjithashtu të drejtën për të marrë pjesë në mbledhjet e organeve të shoqërisë në cilësinë e aksionarit, për të emëruar anëtarët e organeve të shoqërisë, për të përcaktuar përmbajtjen, objektin, afatet, klauzolat dhe kushtet e akteve dhe marrëveshjeve që lidhen me Transaksionin, përfshirë ato të natyrës ekonomike dhe financiare, si dhe për të përmbushur çdo detyrim tatimor dhe për të kryer çdo veprim tjetër të nevojshëm, të përshtatshëm dhe/ose të dobishëm për zbatimin e plotë dhe përfundimtar të Transaksionit.

Këto kompetenca do të ushtrohen me kusht që kushtet përfundimtare të Transaksionit të mos devijojnë në mënyrë materiale drejt kushteve më pak të favorshme nga ato që i janë paraqitur Këshillit të Administrimit.

Alessandra Battaglia
Sekretare e Këshillit të Administrimit
FINCANTIERI S.p.A.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER MARIA M. DANO**



V2026053190293788929

DATE 31/08/2026

NR REP 3742

VËRTETIM PËRKTHIMI

Sot, më datë 31/08/2026, para meje Notere MARIA M. DANO, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Mihal Duri, Nr. 4, u paraqit personalisht:

PËRKTHYES: **Z. Saimir Shefa**, atësia Kujtim, amësia Behije, shtetas Shqiptar, lindur në Lushnjë, Lushnjë dhe banues në LUSHNJE, me adresë Lute Bano 01710137; Nd. 59; H. 1; Ap. 3; Lushnjë; Lushnjë; 9001; Lushnje, lindur më 10/09/1984, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036804484 dhe nr. personal I40910100D.

Përkthyesi është i licencuar nga Ministria e Drejtësisë, i cili më deklaroi se përktheu me përpikmëri dhe saktësi dokumentin bashkangjitur nga gjuha angleze në gjuhën shqipe dhe e nënshkroi rregullisht përpara meje Noteres.

Në referim të nenit 135, i ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 “Për Noterinë”; në Republikën e Shqipërisë unë Noterja vërtetohet nënshkrimi i përkthyesit.

Në zbatim të ligjit nr. 124/2024, datë 19.12.2024 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”, unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij akti, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER/ MARIA M. DANO

